

PASSION

Produkt per mbrojtjen e bimeve

Fungicid sistemik me aktivitet parandalues, kurues dhe bllokues për luftën kundër hirit, kromave dhe monilies në mollë, dardha, pjeshkë, hardhi, duhan, kultura kopshtare/zbukuruese dhe luleshtrydhe.

Përmbajtja: Penconazole 100 g/l

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshem (EC)



KUJDES

DEKLARATAT E RREZIKUT

H319 - Shkakton acarim serioz të syve.

H361d - Dyshohet për dëmtim të fëmijës së palindur.

H411 - Toksike për jetën ujore me efekte afatgjata.

EUH401 - Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.

DEKLARATAT PARANDALUESE:

P102 - Mbajeni jashtë mundësive të fëmijëve.

P201 - Merrni udhëzime specifike përpara përdorimit.

P261 - Shmangni frymëmarrjen e pluhurit.

P270 - Mos hani, pini ose pini duhan kur përdorni produktin.

P273 - Mos e lëshoni në mjedis.

P281 - Përdorni pajisjet e nevojshme mbrojtëse personale.

P308+P313 - nese ekspozoheni, merrni këshilla/vëmendje mjekësore.

P305+P351+P338 Ne rast kontakti me syte: shpëlarjeni tërësisht për disa minuta. Hiqni çdo lente kontakti nëse është e lehtë për ta bërë këtë. Vazhdoni shpëlarjen.

P391 - Mblidhni derdhjet.

P405 - Mbajeni të mbyllur.

P501 - Hidhni produktin/kontenierin në përputhje me legjislacionin aktual.

Udhëzime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:

Organet e prekura: sytë, lëkura, mukozat e rrugëve të frymëmarrjes, mëlçia, veshkat.

- Shkakton leziona të rënda alergjike të lëkurës.

- Shkakton kollë dhe bronkospazmë për shkak të acarimit bronkial.

- Në rast të gëlltitjes, shfaqen simptoma të gastroenteritit (të përziera, të vjella, diarre) dhe dhimbje koke.

Metabolizmi: pas gëlltitjes, substanca përhithet dhe metabolizohet lehtësisht. Ekskretimi renale dhe fekale ndodh në 72 orë.

Terapia simptomatike.

Perdorimi:

Në hardhi: kundër hirit (*Uncinula necator*) dhe kalbezimit të zi (*Guignardia spp.*) me dozen 25-30 ml/100 lit ujë. Trajtimet fillojnë nga faza e 3-5 gjetheve dhe përsëriten çdo 14 ditë. Nuk rekomandohen më shumë se 3 trajtime në sezon.

Në mollë & dardhë: kundër hirit (*Podosphaera leucotricha*) dhe kundër kromave (*Venturia inaequalis* & *Venturia pirina*), me dozen 30-40 ml/100 lit ujë. Bëhen spërkatje me volum të madh (rreth 6 lit/pemë), që fillojnë me fryrjen e sythave dhe përsëritet në fazën e 3-5 gjetheve, kur lulet janë çliruar por janë ende të mbyllura, në rrëzimin e petaleve dhe në fazën e lidhjes së frutave (çdo 2 javë).

Në pjeshkë: kundër hirit të pjeshkës (*Podosphaera tridactyla*, *Sphaerotheca pannosa*) dhe kalbëzimit të frutave (*Monilia spp.*), me 40- 50 ml/100 lit ujë. Aplikohen 2 aplikime çdo 10-14 ditë.

Në perime (domate, kastravec, pjeper, shalqi, spec, patëllxhan, kungull etj.): kundër hirit (*Erysiphe cichoracearum*, *Sphaerotheca fuliginea*, *Leveillula taurica*), me dozen 50 ml/100 lit ujë. Aplikohen deri ne 3 trajtime ne interval 8-10 dite ndermjet tyre.

Në duhan: kundër hirit (*Erysiphe cichoracearum*), me dozen 30-50 ml/100 lit ujë. Trajtimet fillojnë me shfaqjen e infeksionit dhe përsëriten çdo 10 dite.

Luleshtrydhe: kunder hirit (*Sphaerotheca macularis*), me dozen 50 ml/100 lit uje. Aplikohen 2 trajtime cdo 10 dite.

Në bimët zbukuruese, kundër hireve dhe ndryshqeve, me 25-50 ml/100 lit ujë.

Verejtje per perdorimin:

Përzihet me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes. Në rast të përzierjes me formulime të tjera, kryeni paraprakisht një test përputhshmërie.

FITOTOKSICITETI:

Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme

NDIKIMI NE MJEDIS:

Mesatarisht helmues për gjitarët, zogjtë dhe për bletët. Mesatarisht helmues për peshqit. Helmues për jovertebroret ujore. Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

KARENCA:

Pezulloni trajtimet 14 ditë para vjeljes për mollën, dardhën, pjeshkën, hardhinë,; 3 ditë për kulturat e tjera.

MAGAZINIMI:

Preparati ruhet në shishe të mbyllura, në vende të thata e të ftohta. Evitoni ruajtjen në temperatura mbi 40 grade C.

Numri dhe data e regjistrimit:

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: 10 ml deri ne 1 L.

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: ;

Data e prodhimit: ;

Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: shishe plastike PET ose COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e kërkuarit: Sharda Cropchem España, S.L. Adresa: Edificio Atalayas business Center - Carril Condomina no. 3, 12th floor - 30006 Murcia, Spanje.

Emri dhe adresa e prodhuesit:

1. SPACHEM S.L. – Guadasequies (Spanje)

2. I.R.C.A. Services S.P.A.– Fornovo S.G.(Itali)

3. LERIDA UNIÓN QUÍMICA S.A. (LUQSA) – Lleida (Spanje)

4. CHEMARK ZRT, Berhida - Peremarton Gyartelep (Hungary) ELLAGRET S.A. – Greqi.

5. SHANGAI HEBEN Eastchem Medicamnts Co. Ltd. – Shangai (Kine)

Importues dhe ambalazhues: Shegaj Agr shpk. Adresa: Dobrac, Shkoder.

